



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government



Ministria e Punëve të Brendshme / Ministarstvo Unutrašnjih Poslova
Ministry of Internal Affairs

Akademia e Kosovës për Siguri Publike
Kosovska Akademija za Javnu Bezbednost / Kosovo Academy for Public Safety

BORDI I RRJETIT ALUMNI

RAPORT I AKTIVITETIT TË BORDIT ALUMNI

I. TË DHËNAT BAZË

Titulli i aktivitetit:	Takimi konstituiv i Bordit të Rrjetit ALUMNI
Data:	12.11.2025
Vendi:	Salla e takimeve, nr. 24, Objekti Drejtorisë Përgjithshme AKSP
Lloji i aktivitetit	<i>Takim</i>

II. PJEËMARRËSIT

1. Z. Nazmi Zogaj – Anëtar
2. Z. Salih Ademi – Anëtar
3. Z. Shpëtim Morina – Anëtar
4. Z. Rustem Uka – Anëtar
5. Z. Avni Istrefi - Kordinator

Mungoi:

Znj. Zijavere Keqmezi – Anëtare.

Të ftuar tjerë:

1. Z. Shpend Shabani, U.d Drejtor i Përgjithshëm i AKSP-së
2. Z. Fitim Osmani, U.d. Drejtor i DPSÇL
3. Z. Emin Uka, Udhëheqës i Divizionit për Sigurimin e Cilësisë

Sekretaria e Bordit të Rrjetit Alumni:

1. Znj. Hakife Jusufi,
2. Z. Sokol Gjata

III. PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT

Më 12 nëntor 2025, në ambientet e Akademisë së Kosovës për Siguri Publike (AKSP) në Vushtrri, u mbajt takimi i parë dhe konstitutiv i Bordit të Rrjetit Alumni. Në këtë takim morën pjesë ish-studentë të AKSP-së, sot pjesëtarë të institucioneve të ndryshme të sigurisë publike, duke shënuar një hap të rëndësishëm drejt forcimit të bashkëpunimit afatgjatë ndërmjet Akademisë dhe ish-studentëve të saj.

Mbledhjen e hapi u.d. Drejtori i Përgjithshëm i AKSP-së, z. Shpend Shabani, i cili theksoi se ky takim shënon hapin e parë drejt funksionalizimit të plotë të Rrjetit Alumni, një strukturë me rëndësi të veçantë për institucionin tonë dhe për të gjithë ish-studentët e programeve të arsimit të lartë të AKSP-së. Ai nënvizoi se ky proces është thelbësor për fillimin e punës së Rrjetit dhe për krijimin e një platforme bashkëpunimi ndërmjet alumnive, me qëllim zhvillimin profesional, rrjetëzimin dhe mbështetjen e misionit të AKSP-së, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Drejtori i AKSP-së shprehu mbështetjen e plotë për punën e Bordit, duke inkurajuar anëtarët të kontribuojnë aktivisht në realizimin e aktiviteteve të planifikuara dhe duke theksuar rëndësinë e angazhimit të ish-studentëve për zhvillimin e mëtejshëm të Akademisë.

Rrjetit Alumni ka për qëllim forcimin e marrëdhënieve ndërmjet AKSP-së dhe ish-studentëve të saj të arsimit të lartë. Rrjeti synon të ofrojë këshilla dhe rekomandime për zhvillimin institucional të AKSP-së, të nxisë krijimin e rrjeteve profesionale në fushën e sigurisë publike dhe të promovojë vlerat e arsimit dhe etikës profesionale. Në kuadër të aktiviteteve të tij, Rrjeti Alumni organizon takime të alumnive, konferenca dhe punëtori profesionale, programe mentorimi për studentët e rinj, si dhe aktivitete sociale, kulturore dhe sportive. Gjithashtu, mbështet projekte kërkimore dhe publikime shkencore, duke kontribuar në rritjen e reputacionit të AKSP-së brenda dhe jashtë vendit.

Takimi u zhvillua sipas rendit të ditës si në vijim:

1. Zgjedhja e Kryesuesit të Bordit të Rrjetit Alumni;
2. Diskutimi mbi hartimin e planit vjetor të aktiviteteve;
3. Diskutimi rreth përcaktimit të formularit për regjistrimin e anëtarëve të Rrjetit Alumni;
4. Të ndryshme.

Gjatë këtij takimi, Bordi me votim unanime zgjodhi Kryesuesin e tij znj. Zijavere Keqmezi, ish-studente e AKSP-së dhe përfaqësuese nga Dogana e Kosovës,

Në takim u diskutua gjithashtu për fillimin e procesit të hartimit të planit vjetor të aktiviteteve, ku u paraqitën ide fillestare dhe prioritete që do të udhëheqin punën e Rrjetit gjatë vitit të ardhshëm.

Takimi u mbyll në një atmosferë konstruktive dhe bashkëpunuese, duke vendosur një themel të fortë për funksionimin e ardhshëm të Bordit të Rrjetit Alumni të AKSP-së.



IV. REZULTATET / VENDIMET KRYESORE

- Konstituimi i Bordit të Rrjetit ALUMNI të AKSP-së
- Zgjedhja e Kryesuesit të Bordit të Rrjetit Alumni
- Fillimi i hartimit të Planit Vjetor të aktiviteteve të Rrjetit ALUMNI të AKSP-së